



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË
VENDIM

Nr 149 Datë 22/12/2008

Për miratimin e Planit të Veprimit të Zhvillimit të Turizmit në qytetin e Korçës

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Marketingut dhe Turizmit “Për miratimin e Planit të Veprimit të Zhvillimit të Turizmit në qytetin e Korçës” në bazë të Ligjit nr. 8652, dt. 31.07.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, Neni 10, pika III, gërma “a” dhe Neni 32, pika “k”,
mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin e Veprimit të Zhvillimit të Turizmit në qytetin e Korçës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Marketingut dhe Turizmit si dhe te gjithë aktoret e tjere qe veprojnë ne fushen e Turizmit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Raimonda NASE